



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.nr. 7026 /2020

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës Hani i Elezit për vitin 2019 me nr.04/1452/ të datës 17.08.2020 dhe Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit me nr.02/6513/2020, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

V E N D I M PËR PLANIFIKIMIN E SHPENZIMEVE

1. Merret vendim për planifikimin e shpenzimeve në kategori ekonomike, përkatësisht shpenzimet e varrimit dhe shpenzimet për rehabilitim të përgjithshëm për shërbime shëndetësore dhe fizioterapeutike për familjet e dëshmorëve të kryhen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
2. Ky vendim vjen si rezultat i rekomandimeve të raportit të auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019 dhe do të zbatohet nga komuna e Hanit të Elezit.
3. Të gjitha pagesat të cilat do të kryhen për shpenzime të varrimit dhe shpenzimet për rehabilitim të përgjithshëm për shërbime shëndetësore dhe fizioterapeutike për familjet e dëshmorëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi do të kryhen nga kategoria ekonomike Subvencione dhe transfere.
4. Implementimin e këtij vendimi e kryejnë drejtoritë përkatëse e Shërbimeve Publike dhe e Shëndetësisë.
5. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Data: 28.09.2020
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma